



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1369, datë 28.08. 2010

Për
Miratimin e ndryshimeve ne Rregulloren
“Per pajisjet radio dhe fundore te telekomunikacioneve“

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 28.08. 2010, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, shqyrtoi materialin me objekt:

Mbi disa ndryshime qe propozohen per tu bere ne Rregulloren per “Per pajisjet radio dhe fundore te telekomunikacioneve“

BAZA LIGJORE:

1. Shkronja “q” e nenit 8, neni 79 te ligjit Nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*Ligji nr. 9918*);
2. Pika 1 shkronja j) dhe pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP (*Rregullorja e Brendshme*), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;
3. Rregulloren te Miratimit te Tipit “Mbi pajisjet radio dhe fundore te telekomunikacioneve” miratuar me VKD te ERT nr. 67, date 27.07.2001; ndryshuar me VKD te ERT nr. 122.1, date 15.11.2002

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialeve si me poshte:

- Relacioni i hartuar mbi ndryshimet e propozuara per tu kryer ne Rregulloren ” **“Per pajisjet radio dhe fundore te telekomunikacioneve“**
- projektvendim i KD i formatuar dhe arsyetuar;

V Ë R E N:

1. Dokumentacioni “Mbi miratimin e ndryshimeve ne Rregulloren “Per pajisjet radio dhe fundore te telekomunikacioneve“ eshte pregatitur ne perputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator perkates.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë:

- propozimet e Drejtorise se Rregullimit Teknik bazuar në piken 1 shkronja j) dhe piken 17 te nenit 21 të Rregullores së Brendëshme,

V E N D O S I:

1. Të miratojë disa ndryshime ne Rregulloren ”Per pajisjet radio dhe fundore te telekomunikacioneve”, sipas dokumentit bashkëlidhur.
3. Ky vendim te publikohet ne faqen e internetit www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARET E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURCE**

Ndryshimet e miratuara ne Rregulloren egzistuese te Miratimit te Tipit “Mbi pajisjet radio dhe fundore te telekomunikacioneve”

- Ku eshte referuar ligji 8816 date 14.06.2000 “Për telekomunikacionet ne Republiken e Shqiperise” të ndryshohet dhe te vihet neni 8 shkronja “q” neni 79 i ligjit 9918 date 19.05.2008 “Për Komunikimet Elekektroniek në Republiken e Shqiperise”

-Ne te gjithë Rregulloren fjala “**ERT**” zevendesohet me “**AKEP**”

IV. Procedura per Miratim Tipi

ISHTE

1. Subjektet prodhues dhe tregtues qe kerkojne miratim tipi te paisjeve radio dhe atyre fundore te telekomunikacioneve paraqesin ne ERT, ne original ose kopje te noterizuar te origjinalit, kete dokumentacion:

a) Aplikimin per miratim tipi te pajisjes sipas **Lidhjes 3**.

b) Deklaraten ne gjuhen shqipe ose angleze, te prodhuesit te paisjes ose te nje organi te akredituar per konformitetet te paisjes me kekesat esenciale sipas Direktives 99/5/EC.

BEHET

1. Subjektet prodhues dhe tregtues qe kerkojne miratim tipi te paisjeve radio dhe atyre fundore te telekomunikacioneve dergojne ne original ose kopje te noterizuar te origjinalit me poste te zakonshme ose ne rruge elektronike kete dokumentacion:

a) Aplikimin per miratim tipi te pajisjes sipas **Lidhjes 3**.

b) Deklaraten ne gjuhen shqipe ose angleze, te prodhuesit te paisjes ose te nje organi te akredituar per konformitetet te paisjes me kekesat esenciale sipas Direktives 99/5/EC.

c) Specifikimet teknike te pajisjes sipas kompanise prodhuese.

SHTOHET

2. Deklarata e Njohjes se Konformitetit, e cila i leshohet per here te pare nje subjekti aplikant, eshte e vlefshme edhe per cdo subjekt tjeter, i cili kerkon te importoje, ose te vendose ne treg pajisje te te njejtit tip. Procesi i njohjes se konformitetiti qe kryhet per here te pare eshte i vlefshem per te gjitha pajisjet radio dhe pajisjet fundore te telekomunikacioneve identike, pavaresisht nga subjekti aplikant.

SHTOHET

3. Pajisjet radio dhe pajisjet fundore te telekomunikacioneve qe kane kaluar ne proceduren e miratimit te tipit perfshihen ne nje liste qe perditesohet regullisht, e cila publikohet ne faqen zyrtare te AKEP-it ne internet www.akep.al . Per importimin dhe futjen ne treg te pajisjeve te kesaj liste nuk eshte e nevojshme qe subjektet te kryejne proceduren e njohjes se konformitetit.

HIQEN

2. Subjektet jo tregtare dhe perdoruese te paisjeve te radiokomunikimit, krahas kerkeses per frekuenca pune, duhet te paraqesin ne ERT dhe deklaraten e prodhuesit ose te nje organi te akredituar per konformitetet te paisjes me kerkesat esenciale sipas Direktives 99/5/EC.

4. Per subjektet jo tregtare dhe perdorues te paisjeve te radiokomunikimit, te cilet aplikojne edhe per frekuenca pune, ERT shqyrton dokumentacionin perkates te paisjes te paraqitur, gjate procesit te caktimit te frekuencave te punes, dhe kur e gjykon qe brezi i frekuencave qe kerkohen, eshte ne perputhje me Planin Kombetar Radiofrekuencave, miraton perdorimin si tip te ketyre paisjeve, pa leshuar deklarate te vecante.

SHTOHET

4. Per subjektet jo tregtare dhe perdoruese te pajisjeve radio e pajisjeve fundore te telekomunikacioneve, procesi i Miratimit te Tipit eshte i detyrueshem vetem per ato pajisje, te cilat nuk perfshihen ne liste dhe qe per here te pare importohen ne Shqiperi.

ISHTE

3. ERT, brenda 5 diteve nga data e dorezimit te dokumentacionit sipas pikes IV.1, nga subjektet prodhuese ose tregtare, shqyrton kete dokumentacion dhe kur e gjykon te rregullt leshon deklaraten perkatese per miratimin e tipit, **Lidhja 4**.

BEHET

5. AKEP, brenda 5 diteve nga data e dorezimit te dokumentacionit sipas pikes IV.1, nga subjektet prodhuese ose tregtare, shqyrton kete dokumentacion dhe kur e gjykon te rregullt leshon deklaraten perkatese per miratimin e tipit, **Lidhja 4**.

ISHTE

5. Çdo refuzim kerkese per miratim tipi motivohet.

BEHET

6. Çdo refuzim kerkese per miratim tipi motivohet.

ISHTE

6. Pergjegjesia per sigurine, funksionimin, cilesine dhe besueshmerine e paisjeve radio dhe fundore te telekomunikacioneve sipas kerkesave esenciale per te cilat ERT ka leshuar dokumentin per miratimin e tipit ose ka miratuar perdorimin, bie plotesisht mbi subjektet qe e kane marre kete miratim.

BEHET

7. Pergjegjesia per sigurine, funksionimin, cilesine dhe besueshmerine e paisjeve radio dhe fundore te telekomunikacioneve sipas kerkesave esenciale per te cilat AKEP ka leshuar

dokumentin per miratimin e tipit ose ka miratuar perdorimin, bie plotesisht mbi subjektet qe e kane marre kete miratim.

ISHTE

7. Dokumenti per miratimin e tipit te paisjeve mund te revokohet kur provohet shkelja e kerkesave esenciale te specifikuara ne Deklaraten e Prodhuesit ose ate te Organit te Akredituar.

BEHET

8. Dokumenti per miratimin e tipit te paisjeve mund te revokohet kur provohet shkelja e kerkesave esenciale te specifikuara ne Deklaraten e Prodhuesit ose ate te Organit te Akredituar.

SHTOHET

9. Ne perfundim te procedures se cdo miratimi te tipit kryhet regjistrimi ne data base i te dhenave kryesore, te cilat jane paraqitur ne deklaratat e leshuara te njohjes se konformitetit.

SHTOHET

10. Per pajisjet radio dhe ato fundore te telekomunikacioneve te cilat kane kaluar ne proceduren e miratimit te tipit nuk egziston nje afat limit vlefshmerie per deklaratat e leshuara te njohjes se konformitetit, ne rast se nuk vertetohet qe keto pajisje kane ndryshime ne specifikimet kryesore teknike, apo ne qofte se nuk ka ndryshime ne Planin Kombetare te Radiofrekuencave dhe ne dokumentat nderkombetare perkatese ku mbeshtetet ky plan.